

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-23-14371-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>AK INVEST DOOEL Tetovo</b>
NUI	<b>4028005146115</b>
Adresa	<b>Maqedoni</b>
Vendi	<b>Tetove</b>
Kodi postar	<b>1200</b>
Numri Telefonit	<b>049423579</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Ak Invest</b>
Adresa elektronike	<b>akinvest307@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>19.04.2024</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit	<b>Arber Fazliu</b>
Adresa e plotë	<b>Ulpiane</b>
Numri i Telefonit	<b>049999199</b>
Numri i faks-it	
Adresa elektronike	<b>arberfazliu01@gmail.com</b>

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

**“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”**

**Autoriteti kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, me date 07.01.2024 bere publikimin e njoftimit per kontrate per : “Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK” si në vijim:**

- ? **Procedurë e hapur,**
- ? **Kontrate publike,**
- ? **Punë, Vlerë e madhe**
- ? **Vlera e parashikuar e kontratës: 22,513,201.67 euro**
- ? **Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi ekonomikisht më i favorshëm!**

**Afati i fundit për dorëzim të tenderëve, ka qen me date 27.02.2024 ora:14:00, Vendi: Zyra e Prokurimit**

**Takimi për hapjen e tenderëve ka qen me datë 27.02.2024 ora:14:00 ne platformën elektronikë te prokurimit.**

**Me date 02.04.2024 është publikuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe letrat standarde për tenderuesin e suksesshëm dhe te eliminuar.**

**Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për Letrën standarde te tenderuesit te pa përgjegjshëm (te eliminuar).**

**Me datë 08.04.2024 dhe brenda afatit ligjorë, kemi paraqitur kërkesë për ri-shqyrtim ne pajtim me kërkesat e nenit 108/A, të LPP-se, kundër vendimit të AK. (Bashkëlidhur me këtë ankese gjeni edhe kërkesën për ri-shqyrtim te dorëzuar në AK).**

**Me datë 16.04.2024, kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim si te pa bazuar (bashkëlidhur e gjeni vendimin e AK).**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☐

Jo ☒

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**Te pa kënaqur me rezultatin përfundimtar, lidhur me njoftimin për tenderuesin e eliminuar dhe vendimit të AK për rezultatin e aktivitetit të prokurimit, me datë 08.04.2024, brenda afatit ligjorë, kemi paraqitur kërkesë për ri-shqyrtim në pajtim me kërkesat e nenit 108/A, të LPP-se, kundër vendimit të AK për rezultatin e aktivitetit në fjalë.**

**(Bashkëlidhur me këtë ankese gjeni edhe kërkesën për ri-shqyrtim të dorëzuar në AK).**

**Me datë 16.04.2024, kemi pranuar refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim si të pa bazuar (bashkëlidhur e gjeni vendimin e AK)**

**Dhe, te pa kënaqur me vendimin e AK për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim si të pa bazuar, parashtrojmë ankese në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik në pajtim me nenin 109 të LPP-se.**

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Të pa kënaqur me Vendimin e Autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë dhe në pajtim me nenin 109 të LPP-së parashtrojmë ANKESË kundër;**

**Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të datës 16.04.2024;**

**Njoftimit te Vendimit te AK për rezultatin e tenderit te datës 2.04.2024**

Pretendojmë se **Ministria e Shëndetësisë**, përmes Zyrtarit përgjegjës të prokurimit ka bërë shkelje të dispozitave të;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i

ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejme do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Ne vijim do ti trajtojmë pretendimet tona ne ANKESË duke e kundërshtuar :

**Vendimin e AK për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim të dt. 16.04.2024;**

Zyrtari përgjegjës i Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A, paragrafit 8, nën paragrafit 8.4 dhe paragrafit 12 të LPP-se, refuzon kërkesën pa i shqyrtuar të gjitha pretendimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

ZPP e ka obligim ligjor që secilin pretendim të ngritur nga pala ankuese, të trajtoj në përputhje me dispozitat e nenit 8.4, ngase duhet të shqyrtoj secilin pretendim ashtu siç është kërkuar nga ankuesi, kurse AK në këtë vendim disa nga pretendimet e ngritura nuk i

ka arsyetuar fare e disa nga to ne mënyre arbitrare është munduar t'i arsyetoj ne kundërshtim te plotë kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT.

Arsyetimi përveç që duhet arsyetuar ai duhet të jetë edhe i arsyeshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore por që vendimi është nxjerrë në shkelje të LPP-se, për arsyet e ne vijim:

**Pretendimi ynë:** Autoriteti Kontraktues na eliminon nga aktiviteti i mëtejshëm i prokurimit për Kërkesën 2 në lidhje me gjendjen ekonomike dhe financiare, ky pretendim ka qene edhe në kërkesën për rishqyrtim, ku, AK me ane te vendimit për refuzim arsyetohet si në vijim:

### **Referohu Ankesit 1 per deshmit 1.1**

Arsyetimi i AK në pretendimin e parë sa i përket kriterit/kërkesave të përzgjedhjes, është i pa pranueshëm, arbitrar, në shkelje të kritereve të përzgjedhjes dhe në shkelje të ligjit.

AK, nuk mund të arsyetoj ne formën me arbitrare dëshmitë e ofruara nga ana jonë të tri bankave, HAKLBANKE, SPARKASSE dhe STOPANSKA BANKA AD, sepse këto dëshmi vërtetojnë katërçipërisht që kompania ka qasje në fonde deri në shumen e përcaktuar.

Është tejet e pa kuptimit kjo sjellje jo profesionale dhe e pa përgjegjshme e zyrtareve përgjegjës të AK, për faktin se kërkesat/kriteret e përzgjedhjes janë ata që i kanë paraparë në NJK dhe DT, kurse ne këtë fazë i shtrembërojnë ato, sepse nga arsyetimi i tyre në këtë vendim, zyrtaret përgjegjës të AK nuk i kanë të qarta kërkesat në lidhje me “mbështetje financiare” dhe “garanci bankare”, ku këto dy dokumente, kanë dallime substanciale ne mes vete, të cilën çështje e kemi ngritur në kërkesën për rishqyrtim, por që nga ana e AK nuk është marrë parasysh. Ju rikujtojmë edhe një herë dallimin ne mes të “**mbështetje**

**financiare” dhe “garanci bankare”,**

Sa i përket Mbështetjes financiare, të tri provat e ofruara nga bankat si HAKLBANKE, SPARKASSE dhe STOPANSKA BANKA AD, dëshmojnë me se miri që bankat kane lëshuar letër përkrahje te pa kushtëzuar sipas kërkesës se autoritetit kontraktues. Sepse ne mënyre specifike ceket qe **kompania ka qasje ne fonde deri ne shumen e përcaktuar.**

Sa i përket Garancisë Bankare, të paragrafi ku thuhet qe kjo letër mbështetje nuk është garanci është ne pajtim te plote me kërkesat për garancione bankare, pasi garancionet bankare lëshohen sipas kërkesës për Garanci dhe kane krejt tjetër qellim dhe funksion si p.sh. garantimin e përmbushjes se mire te obligimeve dhe lëshohet në formatin specifik.

Tjetër, AK ne mënyre flagrante shkel dispozitat e nenit 51, kriteret e përzgjedhjes, paragrafin 1 të LPP-se, për faktin se kriteri/kërkesa ka qenë: *Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje te pakushtëzuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% te plotësohet nga lideri ne rast te grupit).*

Kurse, ne faze e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave dhe tani edhe ne këtë vendim, aplikon kriteret tjera dhe, nuk i merr për bazë kriteret e lartë cekura të cilat vet AK ka kërkuar ne NJK dhe DT si:

**Ka kapital financiar;**

**Mjete te gatshme ne bankë ose**

**Mbështetje bankare- qasje te pakushtëzuar në kredi.**

Pra, AK referuar kërkesës së lartë cekur ka kërkuar tri forma të përmbushjes se kërkesave mbi gjendjen ekonomike dhe financiare dhe, referuar dëshmive të ofruara nga ana jonë, kriteri i përzgjedhjes është plotësuar në tërësi, madje AK në as një formë nuk ka mundur të argumentoj të kundërtën, për faktin se ne kemi mbështetje financiare prej **5,125.000.00**

euro nga tri Banka të licencuara në R. Maqedonisë Veriore.

**Provë:** Letër mbështetje nga HAKLBANKE, SPARKASSE dhe STOPANSKA BANKA AD

### **Referohu Ankesit 1 per deshmit 2.2**

Pra, kushti administrativ sa i përket kërkesës së lartë cekur është përmbushur në tersi nga ana e AK INVEST DOOEL” Tetovë dhe “HIDRO PROJECT” shpk, Tetovë, Maqedoni e Veriut.

Prandaj, vendimi i AK sa i përket këtij pretendimi është nxjerrë në shkelje të dispozitave të nenit 1, paragrafin 3 dhe nenit 56, paragrafit 3 të LPP-se, sepse AK, nuk mund të diskualifikoj ose përjashtoj nga procedurat e tilla për shkak të sjelljeve jo profesionale apo në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, sepse nga arsyetimi i AK, mund të vërtetohet se kemi të bëjmë me vendim arbitrar dhe me tendencë për të manipuluar me provat.

**Pretendimi i dytë dhe i tretë edhe ne këtë fazë mbetet po i njëjti**, sepse, Autoriteti Kontraktues na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit për Kërkesën 4.1, 4.2 deri të 4.10, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, për stafin profesional, me arsyetimin si në vijim:

### **Referohu Ankesit 1 per deshmit 3.3**

AK ne këtë vendim, nuk i merr për bazë pretendimet tona ankimore të paraqitura në Kërkesën për rishqyrtim, por me të njëjtin arsyetim refuzon kërkesën për rishqyrtim pa i

trajtuar e shqyrtuar ato.

Pra, edhe ne këtë rast AK, tejkalon kompetencat dhe autorizimet ligjore sepse nuk mund të diskualifikoj një tenderues për kërkesa/kritere të pa parapara në NJK dhe DT, për faktin se po t'i referohemi kërkesës së AK, nuk është kërkuar që inxhinieri të mos jetë i punësuar edhe në kompani tjetër dhe nuk është kërkuar që kontrata duhet të prezantohet të noteri në formatin origjinal, por është kontratë e noterizuar duke e cekur ne notarizim se është për projektin ne fjalë, gjë që, sipas kërkesave të AK, kontrata për inxhinierin ne fjalë është në përputhje të plotë me kërkesat e AK dhe e noterizuar në përputhje me rregullativen ligjore.

Po ashtu, edhe për inxhinierin e Operatives, të Ndërtimtarisë, të Hidroteknikës, të Elektros, të Makinerisë, të Gjeodezisë dhe eksperti për siguri dhe shëndet në punë, të gjitha kontratat janë në përputhje të plotë me kërkesat e AK sepse të gjitha janë të noterizuar duke e cekur ne notarizim se është për projektin ne fjalë siç është kërkuar nga AK.

Kurse, veprimi i AK, që nuk janë të pranueshme këto dëshmi, vërteton me se miri për arbitraritet dhe sjellje jo profesionale, ngase, me as një kundër argument AK nuk ka mundur të arsyetoj ne aspektin ligjor dhe, pse nuk mund te pranohet një dokument ne formën dhe përmbajtjen siç është prezantuar, përveç një arsyetimi pa përmbajtjeje dhe pa substancë citojmë: **“nuk pajtohem me këtë pretendim”**.

Ne lidhje me këtë, AK, përkatësisht zyrtaret përgjegjës dëshmojnë edhe një herë për, pa përgjegjësi për shkak të vendimeve të tillë pa mbështetje ligjore e faktike, por të ndikuara nga interesat personale dhe të karakterizuara me diskriminim dhe me një shkallë të lartë të jo transparencës, sepse, kërkesa/kriteri ka qenë: **“Kontrata ose marrëveshja e punës për këtë projekt, (e noterizuar)”**, gjë që nga ana jonë janë dorëzuar në përputhje me kërkesën e AK e noterizuar.

Në kontekst me këtë që u cek me lartë, vendimi i AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, është i pa drejtë, i qëllimshëm dhe në shkelje të ligjit, sepse me këtë rast, AK shkel dispozitat e nenit 51, par 1; nenit 59, par 4 të LPP-së, pastaj dispozitat e nenit 40, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a;b dhe c, të Rregullores 01\_2022 të KRPP-së, për shkak të interpretimit të pa drejtë të kriterëve të përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT dhe rrjedhimisht vendimi i AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim ne lidhje me pretendimet e cekura me lartë është i pa qëndrueshme dhe i pa pranueshme nga ana e

ankuesit, për faktin se jemi të përgjegjshëm sipas kriterëve të përzgjedhjes dhe kemi ofruar çmimin me te ulet te pergjegjshem sipas kriterëve për dhënie te kontratës.

**Ndërsa sa i përket rezultatit të tenderit në lidhje me njoftimit e Vendimit te AK për rezultatit e tenderit te datës 2.04.2024,** qëndrojmë në tersi prapa kërkesës për rishqyrtim, për veç pretendimeve ne lidhje me CV e inxhinierit te arkitekturës.

**E para:** Arsyetimi i AK në lidhje me pretendimin e parë të paraqitur nga ankuesi sa i përket qarkullimit është si ne vijim:

#### **Referohu Ankesit 1 per deshmit 4.4**

AK ne as një formë nuk ka mundur të arsyetoj pretendimet tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim sa i përket realizimit të projekteve te ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se **25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë (07/01/2024).** Ne rast te konsorciumit, së paku 60% e punëve te përfunduara kërkohet për liderin e grupit.

Pra, pretendim ynë ka qene qe “BM Group”, Prishtinë, nuk e plotëson kushtin administrativ mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kërkesat e pikës 2 të FDT, sepse nuk ka dëshmuar se ka realizuar projekte te ngjashme **deri në njoftimin për kontratë (07/01/2024)** në vlerë jo me pak se 25 milion, ashtu siç është kërkuar nga AK në NJK dhe DT.

Sepse, Lista e punëve të kryera të prezantuara nga BM Group, fillon me numër rendor 1 dhe përfundon me numër 25, ndërsa shuma totale e këtyre kontratave ka vlerën prej 30,901,003.51 euro, por, që, OE ka të përfshira edhe 6 kontrata, (kontratat në numrin rendor 2; 14; 18; 19; 24 dhe 25) te cilat nuk jane te pranushme per kete aktivitet per arsye sepse perfundimi i kontratave eshte me datat sipas Listes se kontratave :

Kontrata me nr rendor 2.- Data e perfundimit 09.01.2024; 31.01.2024; 31.01.2024;

31.01.2024; 15.02.2024; 31.01.2024 dhe 15.02.2024 qe dmth jane te perfunduara pasi qe eshte bere njoftimi per kontrate dhe në total shume e këtyre kontratave është

11,906,177.16€,

**Referohu Ankesit 1 per deshmit 5.5**

Ndërsa kontratat me nr rendor sipas listës se prezantuar 1; 2; 3; 9;15; 23; dhe 25 janë kontrata qe nuk janë te përshtatshme për këtë procedurë te prokurimit pasi qe një pjese e tyre është furnizim siç e kemi elaborar ne këtë kërkesë dhe bie ndesh me kërkesat e NJK dhe DT, ku ne rastin konkret OE i lartë cekur punë të kryera ka vetëm **12,812,117.80€. €**

**Referohu Ankesit 1 per deshmit 6.6**

Kontrata sipas listes se prezantuar me nr rendor 3 ; Nuk perputhet numeri i prokurimit per kontraten ne listen e prezantuar si dhe nr i prokurimit i kontrates te cilen e ka dorezuar.

**Referohu Ankesit 1 per deshmit 7.7**

Kontrata sipas listes se prezantuar me nr rendor 15 eshte kontrate per furnizim

**Referohu Ankesit 1 per deshmit 8.8**

Kontrata sipas listes se prezantuar me nr rendor 23 eshte kontrate per furnizim

**Referohu Ankesit 1 per deshmit 9.9**

Kontrata sipas listes se prezantuar me nr rendor 25 eshte kontrate per instalime elektrike

## Referohu Ankesit 1 per deshmit 10.10

Pretendimi ynë është që kontrata me numër rendor 1 me Bau Holding LLC është **marveshje furnizimi** që nuk i plotëson kushtin administrativ për të qene ne përputhje me kriteret/kërkesat e përzgjedhjes të NJK dhe DT.

Po ashtu OE ka prezantuar kontraten sipas listes me numër rendor 3 e cila sipas listës nuk përputhet me numërin e prokurimit i cili gjendet në kontratë dhe bie ndesh me kërkesat me NJK dhe DT

Pretendimi ynë ka qene që edhe kontrata për furnizimit ne mes te OE fitues dhe IP Petrol për furnizim derisa i njëjti i është referuar si Kontrate për Ndërtim, të lista e kontratave, kontrata ne fjalë është ne numrin rendor 8, e datës 25.02.2022, e vitit 2023 e që nuk i plotëson kushtin administrativ për të qene ne përputhje me kriteret/kërkesat e përzgjedhjes të NJK dhe DT.

Po ashtu OE ka prezantuar Kontrate te furnizimit ne mes te OE fitues me Britania Homes shpk, kontrata me nr. rendor 15 dhe 23 qe i referohen furnizimit qe bie ndesh me kërkesat me NJK dhe DT, ku kontrata me nr 15 nuk është e prezantuar fare ne dosje te tenderit.

.

Madje, AK ne as një formë nuk ka mundur të ofroj kundër argument ne lidhje me interpretimin e KRPP-së, të pyetjes 10, ku nder te tjera sqaron, citojmë: ... në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Por që AK nuk ka ofruar as edhe një arsyetim në lidhje me këtë interpretim të KRPP-se, të ngritur si çështje në kërkesën për rishqyrtim nga ana e Ankuesit.

Për më tepër, po të analizohet arsyetimi i AK, lehtësisht mund të konstatohet se AK ka tejkaluar kompetencat dhe autorizimet ligjore sepse e luan rolin e avokimit të kompanisë BM Group, sepse mundohet të arsyetoj listën e qarkullimit duke marrë disa nga projektet, por që me asnjë argument nuk ka mundur të dëshmojë se BM Group, ka ofruar qarkullimin sipas kërkesave/kritereve të përzgjedhjes të NJK dhe DT e që e bënë të pa qëndrueshëm arsyetimin, sepse BM Group, nuk është i përgjegjshëm dhe nuk e plotëson kushtin administrativ të kritereve të përzgjedhjes

**E dyta:** Arsyetimi i AK në lidhje me pretendimin e dytë të paraqitur nga ankuesi sa i përket Staf Teknik min. 50 punëtor, **prej tyre se paku 20 punëtor të certifikuar** për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë është si në vijim:

### **Referohu Ankesit 1 për deshmë 11.11**

Po ashtu, arsyetimi i AK në lidhje me pretendimin tonë është arbitrar dhe nuk ka mbështetje ligjore, sepse nuk mund të konsiderohet arsyetim ***“Nuk pajtohem me këtë pretendim”***, Nuk mundet të arsyetohet AK me një pasus se nuk pajtohet, por duhet të ofroj kundër argumente në lidhje me pretendimet tona, sepse referuar listës së punëtorëve për vitin 2024 dhe certifikimit të tyre sipas kërkesës së NJK dhe DT, OE në fjalë ka prezantuar gjithsej 51 certifiakta të punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë mirepo ka të prezantuar vetëm **16 punëtor në listën e punëtorëve sipas certifikatave të prezantuar për siguri dhe shëndet në punë** e që nuk e plotëson kushtin administrativ për të qenë i përgjegjshëm siç është kërkuar, **se paku 20 punëtor të certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë.**

Po ashtu, arsyetimi i AK në lidhje me pretendimin tonë është arbitrar dhe nuk ka mbështetje ligjore, sepse nuk mund të konsiderohet arsyetim ***“Nuk pajtohem me këtë pretendim”***, Nuk mundet të arsyetohet AK me një pasus se nuk pajtohet, por duhet të ofroj kundër argumente në lidhje me pretendimet tona, sepse referuar listës së punëtorëve për vitin 2024 dhe certifikimit të tyre sipas kërkesës së NJK dhe DT, OE në fjalë ka prezantuar gjithsej 51 certifiakta të punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë mirepo ka të prezantuar vetëm **16 punëtor në listën e punëtorëve sipas certifikatave të prezantuar për siguri dhe shëndet në punë** e që nuk e plotëson kushtin administrativ për të qenë i përgjegjshëm siç është kërkuar, **se paku 20 punëtor të certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë.**

**E treta:** Arsyetimi i AK në lidhje me pretendimin e ngritur sa i përket stafit teknik pika b), ku kërkohet të jenë se paku nga një udhëheqës për pozicionet kryesore të punimeve, të cilët duhen të jenë teknik të diplomuar në shkolla të mesme dhe me përvoja së paku dy vite pas diplomimit për **12 udhëheqësit është si ne vijim:**

### **Referohu Ankesit 1 per deshmit 12.12**

Pra, edhe ne këtë rast AK nuk ofron kundër argument ne pretendimet tona por njëanshëm i referohet vetëm për elektrikistin Abdyl Morina me arsyetimin se ka kualifikim Bachelor, kinse i ka tejkaluar kërkesat e AK, por nuk e arsyeton pretendimin tonë për pjesën ku diplomat e shkollës se mesme teknike ose certifikatat profesionale te dhëne nga institucionet e akredituara nga Autoritetit Kombëtare i kualifikimeve, janë në përputhje me kërkesat e AK.

BM Group” shpk, në këtë liste ka prezantuar 14 punëtor, ku ne mesin e tyre i plotësojnë kushtin vetëm 8 punëtor, ashtu që stafit që punëtohet teknik me shkolle te mesme ose certifikata nuk e plotësojnë kushtin për shkak se 2 janë me Bachelor edhe 2 janë me certifikata private te **pa akredituar** dhe, rrjedhimisht BM Group” shpk nuk e plotëson kushtin administrativ për te qene i përgjegjshëm.

Prandaj, AK edhe ne këtë rast tejkalon kompetencat dhe autorizimet ligjore sepse nuk mund të trajtoj BM Group, të përgjegjshëm kur me as një prove nuk mund të dëshmoj se BM Group, ka minimumi 20 punëtor të certifikuar për ushtrimin e punëve profesionale në siguri dhe shëndet në punë dhe po ashtu nuk ka mundur të arsyetoj stafin teknik prej 12 udhëheqësve dhe, rrjedhimisht OE ne fjalë është i pa përgjegjshëm, dhe shkel dispozitat e nenit 51, paragrafit 1 të LPP-se dhe nenin 40, par 40.1; 40.2; 40.6 nen par a;b dhe c të rregullores 01/2022, për shkak OE “BM Group” Shpk nuk i plotëson kërkesat profesionale/teknike të nenit 69, par 1, par 6 nen paragrafi 6.1;6.2 dhe 6.5 të LPP-se.

Madje, AK në kundërshtim te plotë me nenin 56, par 1, nen par 1.1 dhe 1.2 dhe nenit 60, par 1, nen par 1.2, e LPP-se, shpërblen me kontratë për OE “BM Group” Shpk edhe pse është i pa përgjegjshëm.

Për me tepër, kriteret e përzgjedhjes janë qenësorë për një vlerësim të drejtë dhe meritore, për faktin se janë kusht administrativ, prandaj në lidhje me këtë ju jemi referuar vendimit të OSHP-se, nr. PSH-765/2022, dt.30.03.2023, si rast i ngjashëm.

Ku nder të tjera citojmë arsyetimin e OSHP-se: [...], *kurse DT përbën dokumentin qenësor të aktivitetit të prokurimit dhe për hire të sigurisë juridike, me paragrafin 3 të nenit 7 të LPP-se, çdo AK i ndalohet shprehimisht çdo shmangieje nga termat dhe*

*kriteret e precizuara në DT, sepse sipas paragrafit 1, të nenit 27 kanë karakter material, kurse devijimi eventual atakon parimin e barazisë sikurse sanksionohet me nenin 7 të LPP-së.*

Në lidhje me këtë, AK në mënyrë të pa drejtë ju është shmangur kriterëve të përzgjedhjes të precizuara në DT, për me tepër aplikon standarde të dyfishta ku në rastin e konsorciumit tonë aplikon kriterë shtesë të pa parapara në NJK dhe DT, për me tepër bënë interpretim të gabuar dhe jo të drejtë dhe shtrembërim të informatave, kurse në rastin e OE “BM Group” Shpk, edhe pse nuk i plotëson kriteret e NJK dhe DT, e trajton të përgjegjshëm, e që, në rastin konkret kemi trajtim jo të barabartë të OE pjesëmarrës në këtë aktivitet, e ku, AK shkel dispozitat e nenit 7, paragrafët 1, 2 dhe 6, të LPP-se, sepse dispozita në fjalë, ndër të tjera, garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues të operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, sepse i tërë qëllimi i normës së mësipërme është siguri i barabarësisë në trajtim të operatorëve ekonomik në mënyrë barbare dhe jo diskriminuese.

Sjellim në vëmendje se barazia para ligjit është një prej të drejtave themelore të garantuar me nenet 3 dhe 24 të Kushtetutës. Më tutje, në bazë të Nenit 21, paragrafit 4 të Kushtetutës, këtë të drejtë kushtetuese e gëzojnë edhe personat juridik, duke përfshirë edhe kompanitë.

Barazia para ligjit, sipas interpretimeve gjyqësore, kërkon që personat (fizik dhe juridik) të kenë trajtim të njëjlojtë, kur janë në rrethana të njëjta – siç janë operatorët ekonomik në rastin konkret.

Sidoqoftë, në asnjërin nga këto momente nuk u veprua konform legjislacionit në fuqi, kështu, Operatori Ekonomik OE “BM Group” Shpk, mbeti prapë në garë për shpërblim me kontratë, përveç se kësaj here tejet më i favorizuar duke u shpërblyer me kontratë pa i plotësuar kriteret e përzgjedhjes dhe pa qenë OE i përgjegjshëm, madje AK duke e mbrojtur OE dhe për me tepër duke e luajtur rolin e avokimit të kompanisë.

Prandaj, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me të ulët, kërkojmë nga **OSHP-ja**, të nxjerr:

## VENDIM

Të nxjerrë vendim meritore me të cilin të aprovoj ANKESEN të bazuar të paraqitur nga **GOE “AK INVEST DOOEL” Tetovë dhe “HIDRO PROJECT” shpk, Tetovë;**

Te anulohet vendimi i AK – **Ministria e Shëndetësisë**, për refuzim të kërkesës për Ri-shqyrtim;

Të anulohet njoftimi B45 për tenderuesin e suksesshëm dhe Vendimin B58 për dhënie të kontratës për OE “BM Group” Shpk, sepse është i pa përgjegjshëm;

Te kthehet rastin në Ri-Vlerësim dhe vlerësimi të bëhet me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë duke shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm **“AK INVEST DOOEL” Tetovë dhe “HIDRO PROJECT” shpk, Tetovë.**

### 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Sigurimi i Tenderit, Dokumentet për përgatitjes e tenderit për konkurrim**

**Ankesat, Dëmit ekonomik dhe financiar i fitimit të planifikuar shumës së projektit 10% dhe**

**Humbja e imazhit.**

### 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.